



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRIA
INSPEKTORATI QENDROR

URDHËR I BRENDSHËM

Nr. 3, datë 05.01.2015

**“PËR
NJË NDRYSHIM NË RREGULLOREN PËR PARANDALIMIN E KONFLIKTIT TË
INTERESAVE NË USHTRIMIN E FUNKSIONEVE PUBLIKE NË
INSPEKTORATIN QENDROR ”**

Në zbatim të ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011, “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, ligjit nr. 9367, datë 7.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, si dhe në ligjin nr. 9049, datë 10.04.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Riformulimin e pikës 5 të nenit 2 me këtë përmbajtje : “Autoritet përgjegjës” në kuptim të kësaj rregulloreje është njësi ose personi i caktuar me urdhër të Inspektorit të Përgjithshëm për ndjekjen në vazhdimësi të procesit të deklarimit të interesave private dhe konfliktin e interesave të Inspektoratit Qendror.
2. Shtohet neni 10/1 “ Caktimi dhe statusi i Autoritetit Përgjegjës” si më poshtë:
 - a) Si rregull autoritet përgjegjës caktohet personi apo njësi e ngarkuar me menaxhimin e burimeve njerëzore.
 - b) Autoriteti përgjegjës është njësi apo person që do ketë për detyrë ndjekjen në vazhdimësi të procesit e deklarimit të interesave private dhe konfliktin e interesave të Inspektoratit Qendror.
 - c) Në përshkrimin e pozicionit të punës, për detyrën e autoritetit përgjegjës, vendosen kritere dhe për njohjen e ligjeve për deklarimin e pasurive dhe parandalimin e konfliktit të interesave.
 - d) Për emërimin, lëvizjen apo largimin nga funksioni të autoriteteve përgjegjës, njoftohet paraprakisht Inspektori i Përgjithshëm i ILDKPI.

3. Tek neni 10 shtohen pikat si më poshtë:

h) Autoriteti Përgjegjës, në emër të institucionit, kryen verifikim dhe hetim administrativ lidhur me interesat private, që mund të bëhen shkak për lindjen e një konflikti interesi, në të gjithë regjistrat publikë apo institucione të tjera duke shfrytëzuar të gjithë mundësitë që i jep ligji, dhe informon për këtë eprorin e drejtpërdrejtë deri tek titullari i institucionit.

i) Autoriteti Përgjegjës, pranon informacion të ofruar nga zyrtarë të tjerë apo persona të interesuar, të siguruar në mënyrë të ligjshme dhe verifikon/kontrollon burimin dhe vërtetësinë e këtyre të dhënave.

j) I komunikon vetë zyrtarit dhe eprorit, të dhënat e mbledhura dhe shkeljet e konstatuara, duke i orientuar gjithashtu për masat që duhet të marrë vetë zyrtari apo eprori për zgjidhjen e konfliktit sipas përcaktimeve të bëra në nenin 37 dhe 38 të ligjit nr. 9367, datë 7.04.2005, i ndryshuar.

k) Plotëson dhe administron regjistrin e konfliktit rast për rast të interesit, i cili duhet të përmbajë të dhëna lidhur me:

i) Identitetin e zyrtarit;

ii) Interesat privatë të tij, të cilët janë bërë shkak për një konflikt interesi;

iii) Thelbin e konfliktit;

iv) Palët e interesuara;

v) Burimin e të dhënave, mënyrën e marrjes dhe verifikimit të tyre;

vi) Vendimin që është marrë, mbështetur në këto të dhëna, përfshirë edhe vendimet e marra nga eprorët, institucionet eprorë ose nga gjykatat.

l) Përgatit jo më vonë se 31 Janar i vitit pasardhës, raportin vjetor mbi veprimtarinë e kryer dhe e dërgon në ILDKPKI.

m) Autoriteti Përgjegjës në zbatim të përcaktimeve të bëra në nenin 3 të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë", i ndryshuar, duhet të përgatisë listën e përditësuar të zyrtarëve të cilët në varësi të funksionit që kryejnë mbartin detyrimin për deklarim të interesave private, dhe të dërgojë kopje të saj në ILDKPKI.

n) Në rastet e emërimeve dhe largimeve të zyrtarëve që mbartin detyrim për deklarim, duhet të njoftojë menjëherë me shkrim ILDKPKI, lidhur me datën e emërimit/largimit të subjekteve.

o) Orienton dhe udhëzon zyrtarët të cilët mbartin detyrim për deklarim për plotësimin në rrugë elektronike (me kompjuter) të deklaratës së interesave private sipas llojeve (Para fillimit të detyrës, Periodik vjetor, Pas largimit nga funksioni).

p) Informon zyrtarët lidhur me afatet ligjore brenda të cilave plotësohet dhe dorëzohet deklarata e interesave private.

4. Në të gjithë rregulloren shprehja “ligji nr. 9367, datë 7.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” zëvendësohet me shprehjen “ligji nr. 9367, datë 7.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar si dhe shprehja “ligjin nr. 9049, datë 10.4.2003 Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë” zëvendësohet me shprehjen ligji nr. 9049, datë 10.4.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar.

INSPEKTOR I PËRCJITHSHËM
ILIR ZELA

